



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS KRYESUESI I KUVENDIT

Për: Komunitetet jo shumicë në Komunën e Podujevës

F T E S Ë

Për propozimin e kandidatëve për anëtar/e në përbërjen e Komitetit për Komunitete

Komiteti për Komunitete është trup i Kuvendit të Komunës përkatësisht Komitet i përhershëm obligativ, përbërja e të cilit themelohet nga Kuvendi i Komunës me mandat dhe kohëzgjatje të njëjtë me Kuvendin e Komunës.

Komiteti për Komunitete përbëhet prej 9 anëtarëve/eve, nga Kuvendi i Komunës dhe së paku nga një (1) përfaqësues i secilit komunitet jo shumicë që jeton në Komunën e Podujevës, por që shumica e përbërjes së Komitetit duhet të jetë nga radhët e Komuniteteve jo shumicë, si dhe duhet të reflektoj barazinë gjinore prej minimal 50% për secilën gjini.

Kuvendi i Komunës së Podujevës është në proces të konstituimit / themelimit të trupeve ndihmës të tij,

Andaj;

Kërkohet nga Komunitetet jo shumicë që jetojnë në Komunën e Podujevës që në afatin kohor prej 10 ditëve, nga data 06 janar 2026 deri më 16 janar 2026, brenda ditëve dhe orarit të punës të propozohen kandidatët për anëtar/e në Komitetin për Komunitete.

Vëmendje;

Për qëllim të transparencës, propozimet duhet të mjedhin nga takimet e komuniteteve përkatëse, duke hashkëngjitur procesverbalin nga takimi përkatës, dhe listën e nënshkruar të pjesëmarrësve së bashku me numër të letërnjoftimeve të personave pjesëmarrës, dhe të njëjtat dorëzohen në Zyrën e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Podujevës, përmes Qendrës së Shërbimit për Qytetarë.

Podujevë,
06 janar 2026

